

F.1 KATALOGU ONLINE I BIBLIOTEKËS SË KONGRESIT

Regjistrimet janë në formatin MARC 21 dhe të disponueshme në serverin Z39.50 të Bibliotekës së Kongresit.

F.1.1 Dritarja për kërkim

Pjesa e sipërme e dritares për kërkim ndryshon nga dritarja për kërkim të regjistrimet bibliografike në formatin COMARC/B, sepse përmban vetëm fushat për kërkim, fushat për shënimin e pyetjeve për kërkim dhe butonat **Gjej**, **Kërkimi i ri**, **Kërkimi i fundit**. Pjesa e poshtme e dritares për kërkim, ku shfaqen rezultatet e kërkimit, është pothuajse e njëjtë me dritaren për kërkim të bazat bibliografike, mungojnë vetëm fushat për ndryshimin e formatit të rezultateve të kërkimit dhe për përzgjedhjen e pyetësorit të mëparshëm.

Në dispozicion janë këto fusha për kërkim:

- Numri strandard
- Autori
- Titulli
- Viti i botimit

Në shënimin e pyetjeve për kërkim në Katalogun online të Bibliotekës së Kongresit të "Viti i botimit" duhet të jetë e indeksuar e dhëna për vitin e botimit nga zona e 4-të e përshkrimit bibliografik dhe jo e dhëna për vitin e botimit nga fusha me të dhënat e përgjithshme për përpunimin, e cila në të shumtën e rasteve përdoret për kërkim.

- Botuesi
- LC ID
- Gjuha
- Emërtimet lëndore
- Fjalët kyçe

Kur numri i gjetjeve është më i madh se 1.000, mes rezultateve të kërkimit shfaqen 1.000 regjistrimet e para bibliografike.

F.1.2 Paraqitësi

Në paraqitës janë në dispozicion tre skeda, të cilat mundësojnë shfaqjen e regjistrimit në tre formate: **Formati bazë**, **MARC** dhe **MARC origjinal**.

F.1.2.1 Formati bazë

Në formatin bazë shfaqen këto attribute dhe vlerat e tyre, nëse ekzistojnë:

- LCCN
- autori
- titulli
- viti i botimit
- të dhënat për botimin
- seria
- ISBN
- gjuha
- emërtimet lëndore

F.1.2.2 Formati MARC

Në skedë shfaqet kopja e regjistrimit nga formati MARC 21 në formatin COMARC/B.

F.1.2.3 formati MARC origjinal

Në skedë shfaqet regjistrimi në formatin MARC 21.

F.1.3 Kujtesa e fragmenteve e regjistrimeve

Metodat për regjistrimet nga Katalogu online i Bibliotekës së Kongresit, në kujtesën e fragmenteve të regjistrimeve funksionojnë sikurse për regjistrimet nga baza lokale e të dhënave dhe nga COBIB-i.

Për shfaqjen e regjistrimeve në formatin MARC 21 është shtuar metoda **Kujtesa e fragmenteve / Shfaq në formatin origjinal**. Nëse regjistrimin në formatin MARC 21 dëshironi ta printoni, pas metodës **Kujtesa e fragmenteve / Shfaq në formatin origjinal** zgjedhni edhe metodën **Kujtesa e fragmenteve / Printo regjistrimin**.



Shënim:

*Metoda **Kujtesa e fragmenteve / Përgatit regjistrimet për printim** nuk është aktive, kur në kujtesën e fragmenteve keni përzgjedhur regjistrimin nga Katalogu online i Bibliotekës së Kongresit ose ndonjë bazë tjetër e huaj e të dhënave.*